



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 604/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Evadimi i Mbetjeve të rrezikshme spitalore për periudhën 12-mujore në S.U. “Shefqet Ndroqi”, Tiranë*”, me nr. REF-71161-09-10-2020, me fond limit të shumatores së cmimeve për njësi 1,356 lekë (pa TVSH), dhe vlerë të pritshme të kontratave 17,662,240 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Pura Medical” sh.p.k.
Adresa: Ish Reparti i Kipit të Furrnaltës pranë Kombinatit Metalurgjik, Elbasan.
- Autoriteti Kontraktor:** Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë
Adresa: Rr. “Shefqet Ndroqi”, Sauk, Tiranë.
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k.
Adresa: Afër ish-kanalit të acidit, Gurëz, Fushë Kuqe, Lezhë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të ankimuesit.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 11.09.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Evadimi i Mbetjeve të rrezikshme spitalore për periudhën 12-mujore në S.U. “Shefqet Ndroqi”, Tiranë”, me nr. REF-71161-09-10-2020, me fond limit të shumatores së cmimeve për njësi 1,356 lekë (pa TVSH), dhe vlerë të pritshme të kontratave 17,662,240 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.

II.2. Në datën 23.11.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 23.11.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “V.A.L.E Recycling” sh.p.k.	380 lekë, Kualifikuar
2. “Medi - Tel” sh.p.k.	855 lekë, Skualifikuar
3. “Pura Medical” sh.p.k.	1,045 lekë, Kualifikuar
4. “Eco Riciklim” sh.p.k.	1,100 lekë, Kualifikuar

II.4. Në datën 27.11.2020, operatori ekonomik “Pura Medical” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi duke argumentuar si më poshtë:

“[...]Vetë AK në DST dhe Njoftimin e Kontratës kishte parashikuar se shumatorja e cmimeve për njësi për këtë procedurë ishte: 1356 (një mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë)Lekë pa TVSH... Në lidhje me veprimet e mësipërme të AK dëshirojmë të sjellim në vëmendjen Tuaj kuadrin ligjor në lidhje me ofertën anaomalisht të ulet. Neni 56 i ligjit “Per prokurimin publik”, të ndryshuar, shprehet se: Kur autoriteti kontraktor verën se një ose me shume oferta per kontratat e mallrave, puneve apo sherbimeve jane anomalisht te uleta, ai, perpara se të vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes, per:

- a) Anen ekonomike te metodes se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara:*
- b) Zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve:*
- c) Origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi:*
- ç) Zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi.*

2. Autoriteti kontraktor i verifikon keto elemente duke u keshilluar me ofertuesin dhe ne baze te informacionit te paraqitur. Autoriteti kontraktor mund te refuzoje ofertën, kur edhe pas shqyrtimit te informacionit te paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj.

Gjithashtu ne piken 5 te nenit 66 te VKM nr.914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, shprehet se: Pas korrigjimit te gabimeve aritmetike, komisioni i vleresimit te ofertave verifikon nese ofertat e vlefshme jane ose jo me cmim anomalisht te ulet sipas formulese se percaktuar ne dokumentet standarde te tenderit. Perllogaritja e ofertes anomalisht te ulet behet ne menytrat e meposhtme: Ne rastin kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta, ne perputhje me nenin 56 te LPP, oferta vleresohet anomalisht e ulet kur ajo eshte ulur me shume se 25% e fondit limit te perllogaritur.

Ne rastin kur jane te vlefshme tre ose me shume oferta, ne perputhje me nenin 56 te LPP, oferta vleresohet anomalisht me e ulet nese vlere e saj do te jete me e vogel se 85% e mesatares se ofertave te vlefshme,

Sa më sipër fakti që AK ka shpallur vlerësimin për këtë procedurë prokurimi brenda 5 orësh tregon haptazi që nuk ka zbatuar detyrimin ligjor për ti kërkuar V.A.L.E Recycling argumentimin për ofertën anomalisht të ulët. Nuk e kuptojmë se si një ofertë që është rreth 3.5 herë më e ulët se fondi limit nuk i ka bërë fare përshtypje AK.

*Sa i përket zbatimit të ofertës anomalisht të ulët llogaritjet për këtë procedurë janë:
 $3804+1045+1100= 2525 /3= 841.6 * 0.85 = 715.41$*

Cdo oferte poshte vleres 715.41 eshte anomalisht e ulet.

Edhe me sy të lirë kuptohet që oferta e V.A.L.E Recycling është gati gjysma minimumit ligjor të lejuar. Gjithashtu sjellim ne vemendjen tuaj se vlere prj 380 l e ofruar nga Vale Recycling është shumatore për cmimet njesi e 5 Zerave dhe nga nje llogaritje matematikore e thjeshte rezulton se cmimi per kg i bie te jete vetem 78 l/kg. Me nje vlere te tille as qe behet fjale qe O.E të permbushë detyrimet per zbatimin e kontrates per evadim, trajtim dhe asgjesim te mbetjeve spitalore i vetmi shpenzim qe mund te mbuloj O.E me kete vlere eshte kosto e naftes per te ardhur deri ne institucion. [...]"

II.5. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së, konstatohet se, në datën 05.12.2020, me shkresën nr. 123/51 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht ankesën e këtij të fundit, duke arsyetuar si më poshtë:

"[...]AK sqaron sa me poshte :

Në nenin 66, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët pas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlere e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së". Sa më sipër referuar, nëse një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, ku thuhet se:

1. Kur autoriteti kontraktor verën se nje ose me shume oferta per kontrata te mallrave, puneve apo Sherbimeve jane anomalisht te uleta ai perpara se te vazhdoje me procesine vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes per:

a) anen ekonomike te metodes se ndertimit procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara,

b) zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve,

c) origjinalitetin e punëve mallrave apo të shërbimeve të propozuara nga ofertuesi,
ç) zbatueshmerinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushte të punës në vendin ku do të kryhet puna shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktori verifikon këto elemente duke u keshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elemente të saj.

AK gjykon se, parashikimet ligjore sa më sipër, detyrojnë autoritetin kontraktor se, kur vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së. Në këto kushte Autoriteti Kontraktor gjykon se nuk mund të shqyrtojë dhe gjykojë në themel pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues, për sa kohë që një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues, është për parregullsi procedurale nga ana e veprimeve të autoritetit kontraktor.

Per sa me lart AK vendosi :

KVO të kryejë veprimet procedurale sipas nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe të pasqyrojë rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Te mos marre në shqyrtim pjesën tjetër të ankesës, për sa kohë që një nga ankimet për parregullsi procedurale qëndron.[...]”

II.6. Në datën 11.12.2020, operatori ekonomik “Pura Medical” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Vlerësimi i mësipërm brenda 5 orëve dëshmoi se AK nuk kishte zbatuar procedurat e parashikuara në Nenin 56 të LPP sa i përket detyrimit të AK për të zbatuara procedurën për kërkimin e sqarimeve sa i përket ofertës anomalisht të ulët të dorëzuar nga V.A.L.E Recycling dhe kërkua kualifikimin e saj në bazë të ligjit pasi vlera e ofertuar 380 l/kg e shumatores së cmimeve për njësi është jashtë cdo logjike dhe nuk ofron asnjë mundësi për të realizuar kontratën. Sjellim në vëmendjen tuaj se vetë AK ka parashikuar shumatoren e cmimeve për njësi për këtë procedurë në vlerën 1356 (një mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë)Lekë pa TVSH duke bërë që oferta e V.A.L.E Recycling të jetë rreth 350% më e ulët se kjo vlerë. Nisur nga këto fakte kaq evidente iu drejtua AK me anë të Formularit të Ankesës në datën 27.11.2020 duke kërkuar:
-AK të ndjekë procedurën ligjore për vlerësimin e ofertës anomalisht të ulët dhe të skualifikojë ligjërisht V.A.L.E Recycling pasi me vlerën e ofertuar është e pamundur realizimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.

-Shpalljen e PURA-Medical si operatori i renditur në vend të parë.

Nga AK kemi marrë përgjigje me anë të shkresës nr. 123/51 datë 01.12.2020 e cila është dorëzuar nga Posta në datën 05.12.2020 ku AK ka vendosur:

1. KVO të kryejë veprimet procedurale sipas Nenit 56 të LPP dhe të pasqyrojë rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë në sistemin elektronik.

2. Të mos marrë në shqyrtim pjesën tjetër të ankesës, për sa kohë që një nga ankimet për parregullsi procedurale qëndron.

Kjo përgjigje nga AK është shumë evazive dhe dinake pasi ligji nuk parashikon në mënyrë eksplicite të drejtën e AK për të mos marrë në shqyrtim pretendimet e O.E. Sa më sipër me qëllim që mos të humbasim afatet procedurale jemi të detyruar ti drejtohem KPP. KVO pretendon se ka bërë rivlerësimin e procedurës pasi ka zbatuar detyrimin për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët (veprim ky i papasqyruar në sistemin e prokurimeve elektronike për transparencë) dhe ka lënë në fuqi të njëjtin rezultat në datën 04.12.2020 :

<i>Operatorët Ekonomik</i>	<i>Vlera të Ofertuara</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>1. V.A.LE RECYCLING</i>	<i>380.00</i>	<i>JO</i>
<i>2. MEDI-TEL</i>	<i>855.00</i>	<i>PO</i>
<i>3. PURA-MEDICAL</i>	<i>1045</i>	<i>JO</i>
<i>4. ECO RICIKLIM</i>	<i>1100.00</i>	<i>JO</i>

Anëtarët e KVO kanë bërë vetëm një rivlerësim procedural formal dhe nuk i kanë hyrë fare analizës së vlerës së ofertuar. Në sytë e KVO fakti që shumatorja e cmimeve për njësi e ofruar nga V.A.L.E Recycling është 350% më e ulët se fondi limit i parashikuar nga AK nuk ka bërë përshtypje AK. Duke marrë në konsideratë se vlera e ofruar nga O.E i shpallur fitues është për shmatore e 5 zërave, rezulton se cmimi mesatar për grumbullimin, trajtimin, dhe asgjësimin është 76 l/kg. Edhe në procedurën e realizuar me negociim nga AK me objekt „Evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në S.U. Shefqet Ndroqi, Tiranë, me fond limit në vlerën: 4,121,600 (kater milion e njeqind e njezet e nje mije e gjashte qind) Lekë pa TVSH” ku sërish ky operator ka qënë ofertë anomalisht e ulët ka ofertuar në vlerën 159 l/kg... pra dyfishi i cmimit të ofertuar në këtë procedurë. E vetmja mundësi që AK ta realizojë këtë procedurë me cmimin e ofruar nga V.A.L.E recycling është nëse do abuzohet me sasinë në kg!!!! AK ka pasur detyrimin për të zbatuar në fakt dhe jo vetëm ”me letra” procedurën për ti kërkuar O.E analizën e vlerës së ofertuar 76 l/kg! Nuk ka asnjë mundësi ligjore që me këtë vlerë O.E të argumentojë të gjithë elementët e parashikuar në Nenin 56 të LPP si më poshtë: Neni 56 i ligjit “Per prokurimin publik”, te ndryshuar, shprehet se O.E duhet të provojë:

- a) Anen ekonomike te metodes se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara,*
 - b) Zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizirnin e mallrave apo te sherbimeve:*
 - c) Origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi:*
 - ç) Zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi. Sa më sipër me vlerën 76 l/kg O.E nuk mund të justifikojë:*
- 1. Punëtorët e angazhuar për tërheqjen e mbetjeve të cilët duke marrë parasysh se janë edhe mbetje covid duhet të paraqiten cdo ditë në AK.*
 - 2. Konsumin e karburantit duke marrë në konsideratë faktin se këto automjete do vijjnë cdo ditë në Tiranë nga Kurbinë janë të paktën 110 KM rrugë që do bëhen vajtje-ardhje duke cuar shpenzimet e karburantit në minimumi 2000 L.*
 - 3. Kostot për kontenierët 1 përdorimsh dhe qeset që mesatarisht shkojnë rreth 200 L.*
 - 4. Kostot e kontenierëve të tjerë me afërsi rreth 50 kontenierë per cdo sherbim*

5. Kostot për asgjësimin dhe depozitim të mbetjeve në landfille.

6. Kostot e tjera të stafit (ndihmës, ekonomist, etj).

7. Përbushjen e detyrimeve ligjore ndaj shtetit si tatime, sigurime, taksa vendore, taksa të automjeteve, pagesa për licencat, shpenzime operative, amortizime të pajisjeve etj.

A i ka kërkuar AK ti sjellë të paktën 3 fatura lëshuar institucioneve shtetërore ku të vërtetojë realizimi e shërbimit me të njëjtin cmim 76 l/kg. Veprimet e AK në lidhje janë në kundërshtim me Gjurmën “c” dhe “ç” të nenit 1 të LPP, i cili parashikon se qëllimi i këtij ligji është:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik,

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë:

Shpallje e të njëjtit O.E fitues në procedurën me negociim të zhvilluar nga AK në Shtator edhe pse ishte sërish anomalisht e ulët, shpallja e vlerësimit të kësaj procedure brenda 5 orëve pa respektuar procedurat ligjore, dhe lënia në fuqi e vendimit për të shpallur sërish fitues të njëjtin operator ekonomik edhe pse ka ofertuar 3.5 herë më poshtë se fondi limit i parashikuar nga AK dëshmon qartë se fituesi është i paracaktuar. Për lehtësinë tuaj po ju paraqesim edhe njëherë llogaritjet me shpresën që anëtarët e përgjegjshëm të KSHA do ta konstatojnë atë që është e evidente:

$$380+1045+1100=2525 /3= 841.6 * 0.85= 715.41$$

Cdo oferte poshte vleres 715.41 eshte anomalisht e ulet. Me nje vlere te tille as qe behet fjale qe O.E te permbushe detyrimet per zbatimin e kontrates per evadim, trajtim dhe asgjësim te mbetjeve spitalore i vetmi shpenzim qe mund te mbuloj O.E me kete vlere eshte kosto e naftes per te ardhur deri ne institucion.

Sa m sipër, i kërkojmë KPP që:

1. AK të skualifikojë ofertën e paraqitur nga O.E V.A.L.E Recycling në zbatim të pikës 2 të Nenit 56 të LPP si ofertë jo e rregullt në të gjithë elementët e saj.

2. Shpalljen e PURA-Medical si operatori i renditur ne vend te pare.

Mbetemi me shpresë se KPP do ta detyroje AK te korrigjoe shkeljet[...]

II.7. Në datën 24.12.2020, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.123/57prot. datë 22.12.2020, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Pura Medical” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: [...]Cdo oferte poshte vleres 715.41 eshte anomalisht e ulet. Me nje vlere te tille as qe behet fjale qe O.E te permbushe detyrimet per zbatimin e

kontrates per evadim, trajtim dhe asgjesim te mbetjeve spitalore i vetmi shpenzim qe mund te mbuloj O.E me kete vlere eshte kosto e naftes per te ardhur deri ne institucion.

Sa m sipër, i kërkojmë KPP që: 1. AK të skualifikojë ofertën e paraqitur nga O.E V.A.L.E Recycling në zbatim të pikës 2 të Nenit 56 të LPP si ofertë jo e rregullt në të gjithë elementët e saj. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...]”.

III.1.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.3. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor

zgjidhjen teknike zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetohet zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezultojnë anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangijen e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezultojnë anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezultojnë anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezultojnë anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.*

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën ekonomike të operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. dhe nga ky verifikim rezultojnë se, nga ana e këtij operatori është paraqitur oferta ekonomike, plotësuar sipas zërave të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Nga llogaritjet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, referuar bazës ligjore si më sipër cituar (shiko pika III.1.2.), rezultojnë se oferta e shumatores të çmimeve për njësi e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. është anomalisht e ulët dhe sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezultojnë se edhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka konstatuar këtë fakt, pas ankesës të operatorit ekonomik ankimues, dhe ka kërkuar që nga operatori ekonomik të paraqitej analiza e çmimeve të ofruara për njësi, me anë të shkresës nr.123/49prot, datë 01.12.2020.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezultojnë se nga ana e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k., me synim

justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët janë dorëzuar dokumentet për zbërthimin e zërave të ofertës.

III.1.6. Nga verifikimi i bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik rezulton se operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. ka paraqitur analizë të kostos të ofertës totale, e cila lidhet me vlerën e pritshme të kontratës dhe nuk ka paraqitur analizë të kostos për ofertën e cmimeve për njësi, sipas ofertës me anë të së cilës është edhe klasifikuar. KPP riktheson se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, i cili duhet të jap analiza sa më të sakta dhe të qarta për të bindur se oferta e tij është e rregullt në të gjitha elementët e saj. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime të cilat nuk janë të sakta që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët për shumatoren e cmimeve për njësi të ofertuar, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Pura Medical” sh.p.k. qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Pura Medical” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Evadimi i Mbetjeve të rrezikshme spitalore për periudhën 12-mujore në S.U. “Shefqet Ndroqi”, Tiranë”, me nr. REF-71161-09-10-2020, me fond limit të shumatores së cmimeve për njësi 1,356 lekë (pa TVSH), dhe vlerë të pritshme të kontratave 17,662,240 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pura Medical” sh.p.k
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1712 protokoli Datë 11.12.2020;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri